


Tregtia e jashtme e mallrave

Tetor 2021

Tiranë, më 22 Nëntor 2021: Në Tetor 2021 eksportet e mallrave arritën vlerën 34 mld lekë, duke u rritur me 26,3 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 2,5 %, në krahasim me Shtator 2021. Importet e mallrave arritën vlerën 77 mld lekë, duke u rritur me 29,2 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 11,2 %, në krahasim me Shtator 2021. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 43 mld lekë, duke u rritur me 31,6 %, krahasuar me Tetor 2020 dhe me 19,1 %, në krahasim me Shtator 2021.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë dhjetëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 300 mld lekë, duke u rritur me 35,2 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 632 mld lekë, duke u rritur me 29,5 %, krahasuar me një vit më parë. Defiçiti tregtar arriti vlerën 333 mld lekë, duke u rritur me 24,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2020.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Tetor 2021, në rritjen e eksporteve prej 26,3 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +14,3 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +8,0 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,6 pikë përqindje. Ndërsa grupet që kanë ndikuar negativisht janë: “Ushqime, pije, duhan” me -0,8 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me -0,1 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Tetor 2021




Eksportet, gjatë këtij dhjetëmujori janë rritur me 35,2 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +14,3 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +11,2 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me +3,0 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Tetor 2021, në rritjen e importeve prej 29,2 %, krahasuar me Tetor 2020, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +11,0 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +8,1 pikë përqindje dhe “ Produkte kimike dhe plastike” me +3,4 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Tetor 2021



Si dhjetëmujor, importet janë rritur me 29,5 %, krahasuar me dhjetëmujorin e parë 2020. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +6,8 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +5,4 pikë përqindje dhe “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,1 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Tetor 2021, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Tetor 2020 janë: Italia (15,2 %), Kosova (22,7 %) dhe Spanja (103,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Gjermani (10,0 %) dhe Mbretëria e Bashkuar (5,1 %).

Gjatë këtij dhjetëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (23,1 %), Kosova (48,2 %) dhe Spanja (45,0 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Ukraina (20,2 %) dhe Rusia (31,9 %).

Në muajin Tetor 2021, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Tetor 2020 janë: Italia (19,2 %), Turqia (45,8 %) dhe Greqia (26,1 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Gjermania (5,2 %), Zvicra (34,5 %) dhe Austria (16,2 %).

Gjatë këtij dhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (28,4 %), Turqia (45,4 %) dhe Kina (23,7 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Rusia (2,4 %), Zvicra (7,6 %) dhe Ukraina (19,2 %).

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Tetor 2021



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 60,0 %, të gjithë tregtisë. Në Tetor 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,5 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 54,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30,1 %), Greqia (8,0 %), Turqi (7,2 %) dhe Gjermania (6,1 %).

Shkëmbimet tregtare, për dhjetëmujorin 2021, me vendet e BE-së zënë 60,5 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Tetor 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72,2 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 54,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30,1 %), Turqia (7,7 %), Greqia (7,2 %) dhe Gjermania (6,6 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Tetor 2021

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2018	10 - 18	30	21,3	58	1,2	-28	51,7
	Janar– Tetor 18	262	16,0	525	2,8	-264	49,8
2019	10 - 19	27	-10,2	59	1,8	-32	45,6
	Janar– Tetor 19	252	-3,6	541	2,9	-288	46,6
2020	10 - 20	27	-0,5	59	0,1	-32	45,3
	Janar – Tetor 20	222	-12,2	488	-9,7	-267	45,4
2021	10 - 21	34	26,3	77	29,2	-43	44,3
	Janar– Tetor 21	300	35,2	632	29,5	-333	47,4

Tab.2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Tetor 2021

	Eksporte				Importe			
	Tetor 2020	Tetor 2021	Jan, - Tetor 2020	Jan, - Tetor 2021	Tetor 2020	Tetor 2021	Jan, - Tetor 2020	Jan, - Tetor 2021
Vendet e BE-së	20.110	24.950	166.633	216.178	35.976	41.475	282.168	347.285
Austri	185	297	1.298	2.146	732	613	4.776	5.609
Gjermani	1.954	1.758	13.699	16.290	5.314	5.036	37.826	45.458
Greqi	1.342	2.107	10.642	17.607	5.333	6.726	44.023	49.492
Itali	12.567	14.475	101.817	125.355	15.792	18.821	121.153	155.556
Spanjë	1.155	2.350	13.716	19.883	1.123	1.135	8.051	9.367
Kroaci	194	237	1.369	2.226	501	603	5.286	6.344
Të tjera të BE-së	2.713	3.725	24.090	32.671	7.181	8.541	61.053	75.459
Mbretëri e Bashkuar	129	122	663	739	490	818	4.177	5.308
Kinë	469	963	3.859	7.259	5.226	5.639	43.089	53.290
Kosovë	2.957	3.627	20.895	30.963	819	1.317	6.702	10.633
Maqedonia e Veriut	906	1.194	7.103	10.390	818	1.312	7.347	9.742
Rusi	-	1	13	9	750	766	11.663	11.387
SHBA	320	366	2.609	3.664	930	1.075	7.497	13.107
Turqi	240	350	2.145	4.586	5.249	7.651	46.392	67.436
Ukrainë	18	20	343	274	214	207	3.442	2.783
Zvicër	50	108	601	2.071	1.159	759	8.691	8.032
Të tjera	1.689	2.260	16.641	23.429	7.751	15.691	66.970	103.351
Gjithsej	26.888	33.962	221.504	299.561	59.382	76.709	488.138	632.355

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Tetor 2021

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Tetor 2020	Tetor 2021	Jan, - Tetor 2020	Jan, - Tetor 2021	Tetor 2020	Tetor 2021	Jan, - Tetor 2020	Jan, - Tetor 2021
Gjithsej	26.888	33.962	221.504	299.561	59.382	76.709	488.138	632.355
Ushqime, piqe, duhan	4.385	4.171	31.923	35.896	9.657	11.364	91.643	105.482
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	3.459	5.623	31.828	56.595	4.842	11.352	43.505	69.858
Produkte kimike dhe plastike	721	964	6.209	8.515	8.532	10.531	73.574	92.695
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	122	231	1.546	2.020	1.338	1.401	10.522	12.014
Prodhime druri dhe letre	842	1.082	6.955	7.786	2.194	2.990	19.543	22.996
Tekstile dhe këpucë	9.856	9.825	85.062	91.780	8.340	9.245	60.595	73.325
Materiale ndërtimi dhe metale	4.517	8.368	32.983	64.722	6.956	11.776	64.190	89.239
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	2.083	2.792	17.912	23.607	15.120	15.177	105.677	138.968
Të tjera	904	905	7.085	8.640	2.403	2.873	18.889	27.780

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë),**Tetor 2021**

	Itali		Kosovë		Spanjë		Greqi	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
Gjithsej	101.817	125.355	20.895	30.963	13.716	19.883	10.642	17.607
Ushqim, pije duhan	7.739	9.085	3.166	3.711	1.084	1.241	2.685	3.159
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	1.013	1.489	3.822	6.971	11.544	17.895	819	6.215
Produkte kimike dhe plastike	1.672	2.488	1.813	2.603	102	21	473	627
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.345	1.512	5	14	71	2	10	13
Prodhime druri dhe letre	4.227	5.033	641	742	3	67	1.093	1.166
Tekstile dhe këpucë	63.973	72.004	106	142	746	453	4.141	4.028
Materiale ndërtimi dhe metale	10.305	18.023	9.441	14.336	118	179	1.062	1.882
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	8.586	11.693	609	1.237	26	20	52	76
Të tjera	2.957	4.028	1.291	1.208	22	4	307	442

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë),**Tetor 2021**

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
Gjithsej	121.153	155.556	46.392	67.436	43.089	53.290	44.023	49.492
Ushqim, pije duhan	16.261	19.924	4.396	5.629	638	816	13.374	13.525
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	5.164	8.844	3.070	4.278	7	11	7.760	8.512
Produkte kimike dhe plastike	15.628	19.370	6.991	8.933	4.525	7.304	6.447	7.736
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	8.467	9.820	259	352	467	604	28	28
Prodhime druri dhe letre	4.763	5.351	2.437	2.853	683	607	3.027	3.335
Tekstile dhe këpucë	26.610	34.577	12.890	15.504	8.196	9.602	3.106	2.818
Materiale ndërtimi dhe metale	14.305	20.467	8.067	17.174	5.205	4.525	6.695	9.220
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	25.911	31.636	6.325	8.737	19.083	24.696	2.382	2.819
Të tjera	4.045	5.566	1.956	3.975	4.287	5.125	1.203	1.498

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F,O,B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejitimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C,I,F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri